BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AUTORITETIN KOMBËTAR PËR SIGURINË E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR (AKSIK)

Bazuar në ligjin nr. 10/2023, datë 2.2.2023, "Për informacionin e klasifikuar", në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 26.12.2024, "Për miratimin e rregullores 'Për klasifikimin, punën, transportimin fizik, deklasifikimin, zhvlerësimin, asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror', të NATO-s, të Bashkimit Evropian, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare'", dhe në vendimin e Autoritetit Klasifikues për deklasifikimin e informacioneve të klasifikuara "Sekret shtetëror" në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) janë deklasifikuar informacione të klasifikuara "Sekret shtetëror", si më poshtë:

a) Deklasifikoi pjesërisht informacionin e mëposhtëm me vendimin nr. 103, datë 9.4.2025, të Autoritetit Klasifikues:

1. Informacion i prodhuar nga AKSIK-u nr. 9903, datë 3.11.2022, me lëndë "Ndërprerje e procedurës së pajisjes me CSP", klasifikuar "I kufizuar", deklasifikuar pjesërisht;

b) Deklasifikoi plotësisht informacionin e mëposhtëm me vendimin nr. 403, datë 11.11.2025, të Autoritetit Klasifikues:

1. Informacion i prodhuar nga AKSIK-u nr. 5036, datë 11.11.2025, me lëndë "Dërgohet raporti për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit z. Aurel Trifon Zarka", klasifikuar "Sekret", deklasifikuar plotësisht;

c) Publikimi i bibliografisë të bëhet në Fletoren Zyrtare dhe në *web*-in e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK).

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Altin Jani